

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Lartë la Veliajn në burg/ Tabaku: Rama bashkëpërgjegjës për korrupsionin në Tiranë
ADRESA	https://piranjat.al/politike/gjykata-e-larte-la-veliajn-ne-burg-tabaku-rama-bashkepergje-gjes-per-kor-i104199
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 10:29:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 10:22:49 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	9103169a6d81cbab822131927b1e2200674c399f37682ec1c6de5265c31e4e1b
TEKSTI	d0f99233d432be090622d1527e3b102ff37b66b65d44539a6cfdc4462d242b81
PAMJA	69263b7862d439c38fef1612e007dc56f5bb405a203a0d871908dff83587dece

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	36a030d3ea3d45599448e4ab5a329db99dd144f279655c614102ec83c9a54bb7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0ae22dd21f6bca70f134e59ae1dafa22b8b5d83b679efc36f84697e742e9fc20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/36a030d3ea3d45599448e4ab5a329db99dd144f279655c614102ec83c9a54bb7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- EDITORIAL
- EMISIONE
- INVESTIGIME
- AKTUALITET
- SOCIALE
- POLITIKË
- KOSOVA
- BOTA
- SHOWBIZ
- LIFESTYLE
- SPORT

SYRI LIVE



Flash: **banda shqiptare në** ne kundra të një hetimi për një rrjet ndërkombëtar ■ **procedohen arrestimin në** dy të tjerë flagranc&eum... ■ **çfar ne mungesë municionesh** inspektori tha se midis 28 shkurtit dhe 20 apr ■ **banese në Shijak** breve të para të mëngjesit në fshatin ■ **kreun e Bashkisë Tiranë** masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut të Tiranës

POLITIKE

Gjykata e Lartë la Veliajn në burg/ Tabaku: Rama bashkëpërgjegjës për korrupsionin në Tiranë

Piranjat Përditësimi i fundit 15 Shtator 2026, 12:22



Deputetja demokrate Jorida Tabaku ka reaguar pas [vendimit të Gjykatës së Lartë](#) për vijimin e masës së sigurisë “arrest në burg” ndaj kryebashkiakut të Tiranës, Erion Veliaj.

Në një postim në platformën X, Tabaku deklaroi se, pavarësisht përpjekjeve të mazhorancës për ta paraqitur lirimin e Veliajt si të kryer, Gjykata e Lartë vendosi që ai të qëndrojë në burg.

“Prej muajsh kanë vënë në lëvizje propagandën dhe të gjithë energjinë e pushtetit për ta paraqitur lirimin e Erion Veliajt si fakt të kryer. Nuk ia dolën”, shkroi Tabaku.

Sipas saj, përgjegjësia politike për mënyrën se si është qeverisur Tirana nuk mund të kufizohet vetëm te Veliaj, pasi ai është mbështetur dhe promovuar vazhdimisht nga kryeministri Edi Rama dhe Partia Socialiste.

“Erion Veliaj është produkti politik i Edi Ramës dhe Partisë Socialiste. Ata e kandiduan tri herë, e mbështetën dhe e paraqitën si model suksesi. Sot janë bashkëpërgjegjës për mënyrën se si është qeverisur Tirana”, theksoi deputetja demokrate.

Tabaku shtoi se Veliaj ndodhet në bankën e të akuzuarit për korrupsion dhe pastrim parash, ndërsa përgjegjësinë politike ia atribuoi drejtpërdrejt kryeministrit.

“Edi Rama është në bankën e përgjegjësive politike. Mos u fshih pas Veliajt, zoti Rama. Për Tiranën duhet të përgjigjeni ju dhe Partia Socialiste”, shkroi ajo.

Reagimi i Tabakut vjen pasi më herët gjatë ditës ajo publikoi edhe një video, në të cilën pretendonte se sistemi i ngritur nga Rama ishte angazhuar për të lobuar për lirimin e Veliajt.

Postimin e saj deputetja e mbylli me një mesazh politik për zgjedhjet e ardhshme vendore: “Gjykata foli sot. Në vitin 2027 do të flasë Tirana.”

Postimi i plotë:

Prej muajsh kanë vënë në lëvizje propagandën dhe të gjithë energjinë e pushtetit për ta paraqitur lirimin e Erion Veliajt si fakt të kryer.

NUK IA QOJEN.

Sot Gjykata e Lartë vendosi vijimin e masës “arrest në burg”.

Por përgjegjësia politike për Tiranën nuk ndalet te Erion Veliaj. Ai është produkti politik i Edi Ramës dhe Partisë Socialiste. Ata e kandiduan tri herë, e mbështetën dhe e paraqitën si model suksesi. Sot janë bashkëpërgjegjës për mënyrën se si është qeverisur Tirana.

Erion Veliaj është në bankën e të akuzuarit, nën akuza për korrupsion dhe pastrim parash.

Edi Rama është në bankën e përgjegjësive politike.

Mos u fshih pas Veliajt, zoti Rama. Për Tiranën duhet të përgjigjeni ju dhe Partia Socialiste.

Gjykata foli sot.

Në vitin 2027 do të flasë Tirana.

Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 15 Shtator09:54

[Konflikti për pagat e magjistratëve, BIRN: Një kapitull i ri i përplasjeve të Ramës me drejtësinë! Qëllim shpërqendrimi nga protestat](#)

Konflikti për pagat e magjistratëve u shndërrua në një përplasje të re publike mes kryeministrit Edi Rama dhe drejtësi...

POLITIKE 15 Shtator07:43

[Dita e 108-të e protestës, kërkohet dorëheqja e Ramës dhe qeverisë së tij!](#)

Protesta qytetare në Tiranë vijon edhe sot, duke shënuar ditën e 108-të të tubimeve të njëpasnjëshme. Protestuesi...

POLITIKE 14 Shtator22:52

[Hetimet e SPAK/ Tomorri: Temperatura ka ndryshuar! Balluku s’është më e fuqishme si më parë](#)

Gazetari i ekonomisë Klodian Tomorri e cilësoi çështjen e Belinda Ballukut si një nga hetimet me peshën më të madhe fi...

POLITIKE 14 Shtator22:41

[Audiopërgjimi zbardh skemën/ Ron Yeffet: Do të përgatisim një letër zyrtare që të marrim informacione për gazin në Vlorë](#)

Një tjetër audiopërgjim është publikuar mbrëmjen e sotme , ku del në pah se si Roni Yeffet drejton çdo institucion. Au...

POLITIKE 14 Shtator22:41

[Rama çan me thonj pasagjerin, reagon Berisha: Dënoj me forcën më të madhe dhunën brutale të Padrinos](#)

Lideri i opozitës shqiptare Sali Berisha ka reaguar me një shënim në faqen e tij në facebook pas publikimit të lajmit për dhu...

POLITIKE 14 Shtator22:32

[“Nëse Veliaj del nga burgu, do të jetë rrezik për Ramën”/ Analisti: Do të rikthehet më i fortë politikisht](#)

Analisti Fitim Zekthi deklaroi nëse Erion Veliaj lirohet nga burgu, ai mund të rikthehet më i fortë në politikë dhe të pë...

POLITIKE 14 Shtator22:26

[Përgjimi i Roni Yeffet/ Abilekaj: Flet për armë nga Sudani, kjo i heq licencën. Ku shkuan 30 mln euro?](#)

Gazetari Enton Abilekaj ka ngritur pikëpyetje të forta mbi përmbajtjen e përgjimeve të Roni Yeffet, të publikuara nga ish-zëv...

POLITIKE 14 Shtator22:23

[“Korrupsion, dy vila të fshehura si rryshfet dhe 8 akuza për tenderat”, analisti Sulo ngre alarmin: Ç’po ndodh me SPAK? Askush me këto akuza s’i ka shpëtuar arrestit](#)

Analisti Arion Sulo ngriti në “Top Story” pikëpyetje mbi standardin e ndjekur nga SPAK në rastin e Belinda Ballukut, duke e krahasuar...

POLITIKE 14 Shtator22:09

[Hoxha: Balluku shkoi vetë te Delvina Gas me gjithë kupolën e institucioneve dhe udhëhoqi aksionin e bllokimit](#)

Gazetari Artan Hoxha ka hedhur akuza të forta ndaj ish-ministres së Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, lidhur me atë ndë...

POLITIKE 14 Shtator22:07

[“Ministrinë e Energjisë ma lini mua!”, Bardhi reagon pas përgjimeve të reja të Ron Yeffet: Kush e drejton realisht shtetin shqiptar?](#)

Kreu i grupit parlamentar i Partisë Demokratike, Gazment Bardhi, ka reaguar pas publikimit të përgjimeve të reja të biznesmenit izraeli...

ME TE VIZITUARAT

POLITIKE 14 Shtator

[FOTO- 'Mos u kthe më në Shqipëri'/ Edi Rama sul...](#)

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 14 Shtator

[EMRAT/ Fermë droge prej 4.5 milionë paund në kl...](#)

Një shtetas shqiptar është dënuar me burg për rolin e tij si kultivues në një fermë kanabisi me vlerë 4.5 milion&eu...

POLITIKE 14 Shtator

["Rama u tmerrua në sarajet e Surrelit" – Berish...](#)


Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka zhvilluar një konferencë për mediat pas rikthimit nga vizita e tij në Shtetet e Bashkuar...

INVESTIGIME 31 Maj14:01


[Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik](#)

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Çdo të premte | ? 20:45 | ??? Syri TV



Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.